

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Nebojsa Boriçiq dhe Avdi Dinaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Mirlinda Mejzini, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit A. B., nga Komuna Lipjan, për shkak të veprës penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A. B., N. G. av. nga Lipjani, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan P.nr.388/2012 datë 03.09.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.1270/2015 datë 04.07.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me 5 tetor 2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit A. B. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan P.nr.388/2012 datë 03.09.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë PA1.nr.1270/2015 datë 04.07.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega në Lipjan, P.nr. 388/2012 datë 03.09.2015, i dënuari A. B. është shpallur fajtor për veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par. 1 të KPK dhe për këtë vepër penale është gjykuar me

dënim me gjobë në shumë prej 500 € të cilën është i detyruar që ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast mos pagese e njëjta do t'i zëvendësohet me dënim burgu ku për çdo 20 € të filluar i llogaritet për një ditë burgimi. Është detyruar i dënuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe 30 € në emër të paushallit gjyqësor. E dëmtuara S. M. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Me rastin e ankesës së mbrojtësit të të dënuarit aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së apelit Prishtinë, PA.1.nr. 1270/2015 datë 04.07.2016.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të tjera të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor dhe shkeljet e ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen, çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo të ndryshohen, i dënuari të lirohet nga akuza.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr.167/2016 datë 01.09.2016, me të cilën ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitës së nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.2 të KPPK, për faktin se me rastin e vendosjes sipas ankesës së paraqitur kundër aktgjykimit të shkallës së parë kanë marrë pjesë gjyqtarët Sh. Q. dhe F. O. të cilët kanë vendosur në shkallë të dytë sipas ankesës së paraqitur kundër aktvendimit P.nr.388/2012 datë 04.03.2013, me të cilin është refuzuar si pabazë kundërshtimi i mbrojtësit i paraqitur kundër akuzës, ku njëherit është vendosur edhe mbi pranueshmërinë e

provave; se aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten në ekspertizën e gjeodezisë të kryer nga A. Xh. të nxjerr në procedurën para penale e i angazhuar nga e dëmtuara.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes rrjedh se kundër akuzës së ngritur, mbrojtësi i të dënuarit ka paraqitur kundërshtim ndërsa Gjykata Themelore – Dega në Lipjan, me aktvendimin P.nr. 388/2012 datë 04.03.2013, e ka refuzuar kundërshtimin e mbrojtësit të të pandehurit.

Kundër aktvendimit të lart cekur ankese ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, ndërsa me aktvendimin P.nr. 291/2013 datë 16.04.2013, refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Qëndron fakti se gjyqtarët Sh. Q. dhe F. O. të cilët kanë marrë pjesë në vendosjen e çështjes me të cilën është refuzuar ankesa e mbrojtësit të të dënuarit e paraqitur kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, e po ashtu edhe pranë Gjykatës së Apelit Prishtinë kanë qenë pjesë përbërëse e kolegjit me rastin e vendosjes sipas ankesës së mbrojtësit të të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, mirëpo, vlen të theksohet se qëndrimi juridik i Gjykatës Supreme të Kosovës në të cilën thirret mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë ka qenë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë qenë në fuqi gjer më 31 dhjetor 2012.

Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të cilat janë në fuqi që nga data 01 janar 2013 kanë ndryshuar, kështu tani sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale më nuk ekziston gjyqtari për konfirmimin e akuzës. Konform dispozitës së nenit 242 par. 2 të KPPK, gjykata cakton gjyqtarin ose trupin gjykues me kryetarin i cili nëpërmjet të një procesi transparent dhe të drejtë cakton shqyrtimin fillestar (neni 245) i cili vendos edhe për kundërshtimet në akuzë.

Per me teper, duhet theksuar se dispozita e nenit 39 të KPPK, parasheh bazat për përjashtimin e gjyqtarëve, ndërsa konform par. 2 të të njëjtës dispozitë ligjore gjyqtari nuk mund të përjashtohet kur ai ka qenë i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale si një anëtar i një paneli shqyrtues.

Poashtu, qëndron fakti se aktgjykimet e kundërshtuara mbështeten edhe në ekspeprtizën e gjeodezisë të kryer nga A. Xh. në procedurën para penale, sipas iniciativës së të dëmtuarës, me rastin e paraqitjes së pushtimit të pronës, edhe pse nuk është e vetmja provë në të cilën bazohen aktgjykimet e kundërshtuara. Duhet theksuar se Stacioni Policor në Lipjan me rastin e paraqitjes së pushtimit të paligjshëm të pronës së të dëmtuarës S. M. nga Nishi, Stacioni Policor në Lipjan ka njoftuar zyrtarët e Kuvendit Komunal Lipjan-në zyrën për kadastrë ku zyrtarët A. Xh. më 29.06.2012 kanë dalur në vendin e ngjarjes të cilët kanë konstatuar pushtimin e paligjshëm të pronës së të dëmtuarës. Vlen të theksohet se gjeodeti A. Xh. është dëgjuar edhe në shqyrtimin gjyqësor më datë 14.07.2015 pranë gjykatës së shkallës së parë, i cili sqaron gjetjet me rastin e daljes në vendin e ngjarjes ndërsa i dënuari dhe mbrojtësi i tij e kundërshtojnë mendimin e dhënë vetëm sa i përket manuelit të kordinatave nga zyret e kadastrave të Kosovës të cilat janë dërguar në Serbi.

Nga çka u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pml.nr.223/2016, më 5 tetor 2016.

Proçesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta